

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE

PROJEKT DOKTORAL

**“KONTAKTET E GJUHËVE BALLKANIKE DHE GJUHËS SHQIPE
VËSHTRUAR NË KUSHTET E DYGJUHËSISË NË LIDHJE ME
STRUKTURAT GJUHËSORE DHE ME ANËT
DIDAKTIKO-MËSIMORE”**

**Koordinator e projektit:
Prof.Asoc.Dr. Eda SHEHU
eda.shehu@unitir.edu.al**

TIRANË, 2022

* PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

- * Në kushtet e sotme të një shoqërie të hapur, të një bote me prirje unifikimi ekonomik, politik, kulturor kontakti i gjuhëve dhe i kulturave merr një përmasë tjetër, duke ndryshuar ekuilibrat gjuhësorë dhe duke sjellë më afër popuj dhe kultura të ndryshme.
- * Në këtë kuadër, në rrafsh të parë dalin çështjet gjuhësoro-metodike që kanë të bëjnë me bilingualizmin, ndërthurjen e kulturave në përgjithësi dhe në veçanti gjatë mësimdhënies, të cilat përfitojnë një dinamikë dhe një përmbajtje të re, sa në rrafshin teoriko-kërkimor, aq edhe në atë të nxjerrjes së përfundimeve dhe të zbatimit gjatë procesit mësimor. Këto çështje marrin karakteristika të tjera kur u referohemi komuniteteve etnike për të cilat gjuha dhe kultura e tyre është diçka më shumë se sa mjet komunikimi ose shoqërizimi.
- * Situata e dygjuhësisë në gjuhët ballkanike e atë shqipe dhe përvetësimi i tyre përbëjnë një situatë që tërheq vëmendjen për dendësinë dhe origjinalitetin e ndërveprimit të faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë.
- * Megjithëse optika e punimit tonë do të fokusohet në aspekte shkencoro-pedagogjike e didaktike, ajo do të dëshmohet mbi një truall linguistik të lëvruar në shumë pikëpamje, të cilat japin lëndë të mjaftueshme për analiza e përgjithësime, që mendojmë se do të jenë të dobishme për nxënësit / studentët dhe mësuesit / pedagogët që lidhen me këto problematika.



OBJEKTIVAT

- * - Si objekt kryesor i këtij projekti është trajtimi i Gjuhëve Ballkanike (**bullgarishtja, greqishtja, turqishtja**) në rrafsh përqasës me gjuhën shqipe, në lidhje me përrputhjet dhe mospërrputhjet leksiko-gramatikore, të njësive njëfjalëshe barazvlerëse me ato togfjalësha në fjalorët dygjuhësh dhe zbatime metodike në të mësuarit e gjuhës së huaj. Kjo lidhet me konstatimin e thjeshtë, se qysh në etapën fillestare në të mësuarit e çdo gjuhe të huaj vërehen një varg vështirësish të theksura, të veçanta, sidomos të shfaqura në dukuritë e mospërrputhjeve, pothuajse në të gjitha nivelet e njësive dhe strukturave gjuhësore të gjuhës amtare dhe asaj të huaj, duke filluar nga niveli i ulët fonetik e më tej, deri në atë morfologjik, sintaksor, leksikor e semantik.

* OBJEKTIVAT

- * - Në mënyrë të veçantë do të studiohet ndikimi i ndjeshëm dhe i vazhdueshëm i gjuhës amtare në procesin e përvetësimit të gjuhës së huaj dhe vartësia e krijimit të aftësive, shprehive që mund të jenë të qëndrueshme dhe të automatizuara për kapërcimin e interferencave që shfaqen në të mësuarit e gjuhëve të huaja.

* OBJEKTIVAT

- * - Në këto çifte gjuhësh që do të krahasojmë, do të nxjerrim në pah tipare thelbësore të përbashkëta dhe të veçanta (sidomos këto të fundit), që përcaktohen nga kushtet historike, fiziko-gjeografike të jetës së njerëzve, nga karakteri i përbashkët i mekanizmave themelorë dhe i kategorive të të menduarit, të emocioneve dhe ndjenjave dhe nga karakteri i përbashkët dhe i veçantë i ndërtimit psiko-fiziologjik i organeve të komunikimit, siç janë: organet e të folurit, të dëgjuarit, të të parit dhe dora.

* OBJEKTIVAT

- * - Studimi i ngjashmërive dhe i dallimeve në dukuritë gjuhësore të gjuhës amtare dhe të huaj që përbën objektin kryesor të këtij projekti, do të ndihmojë për ta organizuar në mënyrë të efektshme dhe më ekonomike procesin e të mësuarit të gjuhës së huaj, duke u kushtuar vëmendje kushteve të përshtatjes së gjuhës ose barties negative të shprehive dhe aftësive nga gjuha amtare në gjuhën e huaj dhe anasjelltas. Këtë studim krahasues të gjuhëve ballkanike ne do t'a bëjmë kryesisht për qëllime gjuhësore, i cili do të gjejë pasqyrimin e duhur në metodikën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja në fjalë, çka do të përfundojë me paraqitjen e një udhëzuesi metodik me ushtrime dhe detyra, që do të lehtësojnë përvetësimin e gjuhëve të huaja dhe kapërcimin e vështirësive.

* ANALIZA E GRUPEVE TË SUNUARA DHE E PALËVE TË INTERESIT NGA PROJEKTI

- * Analiza e grupeve të synuara dhe e palëve të interesit nga projekti do të synojë në përfitimet nga ky projekt prej institucionit në nivel lokal dhe kombëtar. Ne do të ndihmojmë gjithashtu realizimin e objektivave specifike të këtij projekti si dhe veprimtaritë e parashikuara në të, lidhur me nevojat e përfituesit.

* AKTIVITETET E PROJEKTIT

- * **Aktiviteti nr.1** - Seminar pune me pjesëmarrjen e studiuesve jashtë projektit në fund të secilit vit. Paraqitje referatesh nga çdo anëtar i projektit, ku mbi bazën e diskutimeve do të vlerësohen arritjet e shënuara nga secili anëtar.
- * **Aktiviteti nr.2** - Paraqitja e materialeve nga anëtarët e grupit, të cilat do të shërbejnë si bazë për mbajtjen e temave në veprimtaritë organizuese nga Institucionet brenda vendit dhe nga referatet e përbashkëta nga anëtarët e grupit në një veprimtari ndërkombëtare.
- * **Aktiviteti nr.3** - Hartimi i pyetësorit për nxënësit, rezultatet e të cilit do të vlerësohen me botimin e një materiali.
- * **Aktiviteti nr.4** - Hartimi i një materiali në formë monografie për botim si libër, ku do të trajtohen problemet e paraqitura dhe të zgjedhura me projektin.

* REZULTATET E PRITSHME

- * Puna që kryhet për realizimin e këtij projekti lidhet sidomos, me studimin e kufizuar që i janë bërë problemeve të mësimdhënies në rrafshin e përjasjeve ndërmjet tyre në shkollën tonë. Prandaj rezultatet e tij do të shërbejnë për mbushjen e këtij boshllëku dhe për të hapur gjithashtu rrugë të reja për thellimin e mëtejshëm të çështjeve që trajtohen këtu. Këto rezultate do të shpien në konkluzionin se specifika e të mësuarit të gjuhës së huaj në shkollë para së gjithash, qëndron në marrëdhëniet që vihen re ndërmjet sistemit të gjuhës amtare dhe gjuhëve në kontakt (në rastin tonë ballkanike), në veçoritë e këtyre gjuhëve, në të gjitha nivelet e gjuhës dhe në ndryshimet gjuhësore që ndodhin, kur këto gjuhë bien në kontakt. Në këtë qëndron dhe risia e këtij projekti.
- * Specifika e të mësuarit të gjuhës së huaj në shkollë dhe kushtet në të cilat mësohet ajo e bëjnë të nevojshme zgjidhjen e një sërë problemesh të mësimdhënies dhe përcaktimin e ligjësive të përvetësimit të qëndrueshëm të saj.
- * Një ndër çështjet më të rëndësishme të studimit lidhet me përmirësimin e gjendjes së mësimdhënies së gjuhëve të huaja në shkollën tonë, sidomos në shkollën e lartë, duke kryer analiza gjuhësore përjasëse ndërmjet dy gjuhëve në kontakt në gjitha nivelet dhe nxjerrja e konkluzioneve metodike përkatëse nga analiza në fjalë.

* PRODUKTI I PROJEKTIT

- * Rezultatet e këtij kërkimi shkencor do të pasqyrohen në botime të ndryshme në nivel artikujsh, punimesh, vepër në nivel monografie, nga të cilat do të përfitojnë të interesuarit që merren me studimet në fushën përkatëse.

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE

FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!

Grupi i Punës:

Koordinatorë: Prof.Asoc.Dr.Eda SHEHU

Prof.Asoc.Dr.Adriatik Derjaj

Prof.Asoc.Dr.Raqi Bello

Msc.Donika Koci

Tiranë, 2022